



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:018786

Datë: 30.01.2025

Numri i dokumentit: 06778445

KF.nr.898/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtaren Vera Gashi Bala, në konfliktin administrativ të paditësit “Lutian” ShPK me numër unik identifikues 810057499 dhe seli në Ferizaj, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Kushtrim Bytyqi, avokat në Prishtinë, kundër të paditurit Dogana e Kosovës në Prishtinë, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulimin e vendimi, objekt kontesti rivlerësim malli, vlera e kontestit e pa përcaktuar, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik, të mbajtur në mungesë të përfaqësueses së autorizuar të paditësit, dhe në prani të përfaqësueses të palës së paditur Xh. K., me datë 23.01.2025 mori, këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET si e pabazuar, kërkesëpadia e paditësit “Lutian” ShPK me numër unik identifikues 810057499 dhe seli në Ferizaj.
- II. MBETËT NË FUQI Aktvendimi nr. 01.3.2.2/13239 i datës 21.07.2022, i Doganës së Kosovës me seli në Prishtinë.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Paditësi me padinë e paraqitur në Gjykatë, me datë 29.08.2022, përmes përfaqësuesit të tij të autorizuar, ka iniciuar konfliktin administrativ kundër të paditurës Dogana e Kosovës, me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit nr. nr. 01.3.2.2/13239 i datës 21.07.2022 për shkak të shkeljes së dispozitave të Kodit Doganor dhe të Akcizave, dispozitave ligjore të UA 11/2009, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së parimeve dhe rregullave të procedurës administrative. Sipas paditësit, rivlerësimi i bërë nga zyrtarët doganor është kryer në

mënyrë të gabuar dhe në kundërshtim me dispozitat e nenit 33-35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, pasi nuk janë respektuar metodat e përcaktuara për vlerësimin e mallrave. Konkretisht, ankuesi pretendon se rivlerësimi është kryer duke kaluar drejtpërdrejt në metodën e gjashtë të vlerësimit, pa kaluar më parë në metodat paraprake, duke vepruar në mënyrë arbitrare dhe pa respektuar kriteret objektive për përcaktimin e vlerës së mallit. Gjithashtu, ka theksuar se ka poseduar dhe prezantuar të gjitha dokumentet e nevojshme për të provuar vlerën e deklaruar të mallrave, si faturat përkatëse, kontratën e bashkëpunimit, listat e paketimit, faturat e transportit detar dhe tokësor, si dhe deklaratat eksportuese. Këto dokumente janë bashkangjitur në sistemin ASYCUDA dhe kanë mundësuar verifikimin e vlerës reale të mallit, por zyrtarët doganor nuk i kanë shqyrtuar dhe verifikuar këto dokumente siç kërkohet nga legjislacioni në fuqi. Më tej ka theksuar se zyrtarët doganor kanë shkelur dispozitat e Udhëzimit Administrativ nr. 11/2009 për implementimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave, duke mos marrë parasysh dokumentet që importuesi ka paraqitur dhe duke mos dhënë ndonjë sqarim apo arsyetim për mospranimin e tyre. Rivlerësimi është kryer në mënyrë të padrejtë, duke u bazuar në të dhëna të paqarta dhe referenca jo të sakta, gjë që ka rezultuar në një bazë doganore më të madhe, me qëllim të ngarkimit me taksa shtesë. Për më tepër, vlerëson se çmimet e deklaruara nga importuesi për mallrat (pllaka qeramike dhe porcelani) janë çmime të arsyeshme dhe janë të bazuara në dokumentacionin përkatës, si faturat dhe kontrata, të cilat nuk janë marrë parasysh nga Dogana. Ai argumenton se dallimet midis çmimeve të deklaruara dhe atyre të referencës nuk janë të ndjeshme dhe, për këtë arsye, Dogana nuk ka pasur bazë ligjore për të ndryshuar çmimet e deklaruara. Në përfundim, ka pretenduar se Dogana ka bërë një vlerësim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke mos marrë parasysh dokumentet e dorëzuara dhe duke vepruar në mënyrë arbitrare. Kjo ka rezultuar në një ndryshim të padrejtë të çmimit të deklaruar dhe në detyrimin për pagesë të taksave shtesë, pa asnjë bazë të qartë ligjore apo faktike. Gjykatës i ka kërkuar anulimi e vendimit të kontestuar dhe të obligohet e paditura ta kthej mjetet e paguara më tepër në emër të importit të paguara mbi vlerën e transaksionit për shkak të rivlerësimit, në shumën që do të precizohet në procedurë gjyqësore, me kamatë në shkallë prej 8% nga datat e pagesave e deri në kthimin e plotë. Lidhur me shpenzimet e procedurës nuk është deklaruar.

E paditura, në përgjigje në padi e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit. Shton se aktvendimi i atakuar është marrë konform të gjitha dispozitave në fuqi dhe ajo në të cilën pretendon pala se ky vendim është marrë me shkelje ligjore nuk qëndron fare, me arsyetimin se vendimi i atakuar është marrë konform legjislacionit në fuqi dhe në mënyrë të drejtë ndërsa pala paditëse pretendimet e veta nuk i ka vërtetuar as edhe me një provë të vetme, andaj i

propozon gjykatës që ta refuzoj në tërësi si të pa-bazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe ta lë në fuqi vendimin kontestues si të ligjshëm. Në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor, përfaqësuesi i të paditurës ka theksuar se mbesin në tërësi sipas përgjigjes në padi. Gjykatës i ka propozuar që padia dhe kërkesëpadia e paditësit të refuzohet në tërësi si e pabazuar. Pretendimet e paditësit janë të pabazuar sepse paditësi me asnjë dokument relevant juridik siç është kontrata, deklarata eksportuese dhe pagesa bankare nuk i ka të bashkangjitura as në procedurën e deklarimit të të mallit e as në padi. Lidhur me shpenzimet e procedurës nuk është deklaruar.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik të datës 11.04.2024 ka administruar provat si në vijim: Deklaratat Unike Doganore: R12828, 12829, 12830,13021,13023, 13241, 13320, Aktvendim 01.3.2.2/13239 i datës 21.07.2022, Dosja me të dhëna të disponueshme, Ankesë në doganë e datës 24.06.2022, Fatura ZY-012/2021-22, 2 Packing list, Faturat e transportit detar, Faturat 246/22, 247/22, 248/22, 249/22, 251/22, 252/22, Proceset mbi përcaktimin e vlerës së mallrave, Kontrate për shitjen e mallrave, Fatura ZY-013/2021-22.

Gjykata, vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thënieve në padi, përgjigjes në padi, shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë konflikt administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ, nga DUD-at kontestues të Doganës së Kosovës, deklarimeve në ankesë-padi, shkresat e lëndës, aktvendimi kontestues, dhe deklarimeve në seancën e shqyrtimit kryesor, Gjykata ka gjetur se nuk është kontestues fakti se paditësi ka paraqitur DUD-at me R12828, 12829, 12830,13021,13023, 13241, 13320, të proceduar në Zyrën e Brendshme në Ferizaj, me ç'rast të njëjtit janë proceduar, duke u rivlerësuar bazuar në metodën e 6-të. Jo kontestuese mbesin edhe faktet se paditësi, me datë 24.06.2022, ka ushtruar ankesë në Doganën e Kosovës, për të cilat Dogana e Kosovës fillimisht ka nxjerr Aktvendimet nr. nr.01.3.2.2/13239 të datës 21.07.2022 si akt administrativ përfundimtare të nxjerra në procedurën administrative në shkallë të dytë, e ndaj të cilit, paditësi me padinë e datës 29.08.2022, ka iniciuar këtë kontest tregtar-administrativ. Kontestuese mbetet nëse e paditura e ka kryer rivlerësimin në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, të cilat përcaktojnë kushtet kur vlera e deklaruar mund të konsiderohet si vlera reale e mallit.

Nga ekzaminimi i vendimit kontestues, Gjykata konstaton se e paditura shkalla e dytë, Dogana e Kosovës ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të këtij paditësit. E paditura ka arsyetuar vendimin e vet duke argumentuar se Sektori i Pranimit Qendror i Doganës së Kosovës ka vepruar në përputhje me dispozitat e Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës kur ka kontestuar vlerën e deklaruar të mallrave për zhdoganim. Arsyetimi mbështetet në faktin se vlera e deklaruar nga subjekti nuk përputhet me vlerën reale të transaksionit të importit në Kosovë, pasi Sektori ka përdorur metodën e gjashtë të vlerësimit, të parashikuar në nenin 35 të Kodit Doganor, bazuar në të dhënat e disponueshme nga Dogana e Kosovës dhe në vlerësimet e mëparshme për mallra të ngjashme me karakteristika të ngjashme. Procesi i përcaktimit të vlerës së mallit është kryer duke marrë në konsideratë ndryshimet e çmimeve dhe zhdoganimet e mëhershme të mallrave të ngjashme, të cilat kanë vlera më të larta se ato të deklaruara nga subjekti. Më tej ka theksuar se subjekti ka paraqitur dokumentacion për të provuar vlerën e deklaruar, por ky dokumentacion është konsideruar i pamjaftueshëm. Konkretisht, nuk është prezantuar kontrata me shitësin, që do të vërtetonte vlerën reale të paguar, mungon deklarata eksportuese nga shteti eksportues dhe pagesa bankare. Në sistemin ASYCUDA dhe procedurën ankimore nuk është dorëzuar dokumentacion i plotë për të aplikuar nenin 33 të Kodit Doganor. Subjekti ka pretenduar se mallrat (pllaka qeramike dhe porcelani) janë importuar me çmime të arsyeshme bazuar në faturë dhe kontratë, por këto pretendime nuk janë mbështetur me dokumente të mjaftueshme. Dogana ka konstatuar se informacionet e deklaruara nga subjekti nuk janë të besueshme dhe janë në kundërshtim me të dhënat që disponon Dogana e Kosovës. Dogana e Kosovës është mbështetur në të dhëna të besueshme dhe në proceset e përcaktimit të vlerës së mallrave, duke përfshirë dokumentet me ID 1437 dhe ID 1436, të cilat tregojnë vlerat reale të mallrave në raste të ngjashme. Ka përfunduar se Dogana e Kosovës ka vepruar drejtë dhe në përputhje me ligjin kur ka rivlerësuar vlerën e mallit të deklaruar nga subjekti, duke marrë në konsideratë të dhënat e disponueshme dhe mungesën e dokumenteve të vlefshme nga subjekti.

Gjykata ka shqyrtuar ligjshmërinë e aktit administrativ brenda kufijve të kërkesëpadiës, në vështrim të nenit 44, parag. 1, të LKA-së, duke u kujdesur edhe sipas detyrës zyrtare për nulitetin e aktit administrativ, kjo sipas parag. 2, të këtij neni. Gjykata nuk ka mundur t'i merr për bazë pretendimet e paditësit të shprehura në padi, sepse të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga ana e organit të paditur, në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës dhe me dispozitat ligjore në fuqi.

Gjykata vlerëson si të pabazuar pretendimin e paditësit për shkelje esenciale të dispozitave të KDA-së, dhe atë të neneve 33 dhe 34, me arsyetimin e paditësit se zyra e pranimit qendror e Doganës së Kosovës, ka aplikuar metodën e gjashtë të vlerësimit edhe pse ka qenë dashur të aplikohet metoda e parë e vlerësimit konform neni 33, të KDA-së, dhe vetëm në rast se nuk mund të aplikohet metoda e parë e vlerësimit atëherë neni 34, i KDA-se parasheh që metodat e vlerësimit të aplikohen sipas radhës, e i cili pretendim është në kundërshtim me pretendimin e të paditurës, se në rastin konkret subjekti në procedurë këtu paditësi nuk ka ofruar dokumentacion të kompletuar dhe të harmonizuar për të dëshmuar vlerën e deklaruar, kjo pasi që nuk ka deklaruar transfer-pagesë bankare ndërkombëtare të harmonizuar në kuptim të vlerës dhe përshkrimit të numrave të faturave kontestuese, si dhe dokumentacionin tjetër mbështetës për ta provuar vlerat e transaksioneve si të pakontestueshme, e nga i cili arsyetim, Gjykata e pranon si të drejtë konstatimin faktik dhe qëndrimin juridik të bërë nga Dogana e Kosovës, këtu e paditura. Po ashtu, e paditura e ka arsyetuar mjaftueshëm në aktvendimin kontestues edhe kalimin nga njëra metodë e vlerësimit në tjetrën, duke filluar nga metoda e parë dhe në mënyrë kronologjike deri në metodën e gjashtë. Për të pranuar vlerën e paguar të transaksionit sipas metodës së parë të vlerësimit neni 33, të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, në këtë rast paditësi është dashur të dëshmojë vlerat e transaksioneve të cilën ia ka paguar shitësit-eksportuesit të mallit lëndor me të dhëna dhe referenca të sakta në urdhërpagesat ndërkombëtare. Edhe pse pala paditëse ka prezantuar Gjykatës disa nga prova materiale si fatura të mallit, kontrata dhe deklaratën eksportuese, mirëpo të njëjtit nuk kanë arrit të dëshmojnë vlerën reale të paguar për mallin lëndor, prandaj edhe Gjykata i pranon konstatimet e cekura në arsyetimin e aktvendimit kontestues se dokumentacioni përcjellës i mallit është provë e pamjaftueshme, pasi që fakti vendimtar për tu dëshmuar se është paguar vlera e deklaruar e mallit lëndor e që është transaksioni bankar apo çfarëdo pagese tjetër për mallin e importuar, nuk është prezantuar.

Për Gjykatën arsyetimi i Aktvendimit kontestues të Doganës së Kosovës, se dokumentet nuk janë të bashkangjitura as në sistemin Asycuda e as në procedurën e rivendosjes, duke konstatuar se subjekti nuk ka arritur të dëshmojë që vlera e deklaruar është vlerë reale e transaksionit, prandaj edhe vlerësimi i mallit është bazuar në metodën e gjashtë të vlerësimit neni 35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, respektivisht në bazë të të dhënave të disponueshme të Doganës së Kosovës, është plotësisht i bazuar.

Si fakte vendimtare për ta konsideruar si të ligjshëm rivlerësimin e mallit lëndor nga e paditura, për Gjykatën ka qenë mungesa e transaksioneve bankare të harmonizuara në kuptim të vlerës dhe sipas përshkrimit të faturës kontestuese, andaj edhe e paditura Dogana e Kosovës

është bazuar në metodën e 6-të, metodë kjo që gjen zbatim në neni 35, të Kodit Doganor dhe Akcizave. Gjykata vlerëson se në rastet kur nuk kemi prova të mjaftueshme apo se ato janë jo të harmonizuara nga paditësi, atëherë edhe rivlerësimi i mallit lëndor sipas të dhënave të disponueshme sipas nenit 35, të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, është i pranuar dhe mbështetur në KDA, prandaj Gjykata konstaton se është aplikuar drejt dispozita ligjore, respektivisht neni 35 i KDA-së, kur është rivlerësuar malli lëndor.

Gjykata, pretendimin e paditësit se aktvendimi i kontestuar nuk e ka konstatuar drejtë gjendjen faktike, prandaj si i tillë kërkon që të anulohet, përveç të theksuar në padi si të tillë nuk e ka argumentuar me asnjë provë të vetme materiale këtë pretendim e që sipas nenit 7, Parag 1, dhe 3, i Ligjit për Procedurën Kontestimore nr. 03/L-006 parasheh se: *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla, ”* Nga këto dispozitat Gjykata konsideron se përdorimi i mjeteve dhe metodave të provuarit, nënkupton një detyrim për palët dhe respektimin e procedurave ligjore të përcaktuara me ligj. Gjithashtu, sipas nenit 38, par 2, të LKA-se, Gjykata vendos për gjendjen faktike përmes shqyrtimit verbal dhe vlerësimit të fakteve. Pala paditëse duhet të parashtroj faktet, në të cilat mbështetet kërkesa e saj. Esenca e parimit të shqyrtimit qëndron në atë se Gjykata do të merr parasysh vetëm ato fakte, të cilat janë paraqitur dhe shtjelluar nga palët ndërgjyqëse, dhe tanimë është e qartë se barra kryesore për paraqitjen e fakteve dhe provave në një proces gjyqësor u takon palëve.

Gjykata thekson se në nenin 33 par.1 të KDAK-së është parashikuar se: *“Vlera doganore e mallrave të importuara është vlera e transaksionit, që paraqet çmimin vërtetë të paguar ose të pagueshëm për mallrat e shitura për eksport në Kosovë, ndërsa në nenin 34 par.1 të KDAK-së parashihet që “Kur vlera doganore nuk mund të përcaktohet sipas nenit 33, ajo duhet të përcaktohet sipas renditjes kronologjike të nën-paragrafëve (a), (b), (c) dhe (d) të paragrafit 2, duke filluar nga nën-paragrafi i parë (metoda e dytë), që lejon përcaktimin e asaj vlere, me përjashtim të rasteve në të cilat radha e aplikimit të nën-paragrafëve (c) dhe (d) mund të kapërcehet me kërkesën e deklaruesit; Vetëm në rast kur vlera nuk mund të përcaktohet në bazë të një nën-paragrafi të caktuar, lejohet të aplikohen dispozitat e nën-paragrafit që vjen me radhë menjëherë pas tij”.* Konfrom me këto dispozita ligjore, Gjykata konstaton se e paditura në rastin konkret, ka vepruar në mënyrë të drejtë kur ka rivlerësuar mallin e importuar nga paditësi, duke dhënë arsyetim të mjaftueshëm se përse vlerësimi i mallit nuk mund të bëhet me metodën e parë, siç parashihet me ligj, pasi që paditësi rezulton të mos ketë dorëzuar dokumentacionin e kërkuar

ligjërisht dhe kështu ka dështuar të provoj edhe vlerën e transaksionit për mallin e kontestuar, si dhe çmimin vërtet të paguar, siç përcaktohet me nenin 33 par.1 të KDAK-së.

Nga kjo gjendje faktike, gjykata ka pranuar si të bazuar arsyetimin e vendimit të paditurës, për arsye se paditësi nuk ka arritur të argumentojë me prova konkrete një gjendje tjetër faktike nga ajo që është vërtetuar nga e paditura me vendimin kontestues dhe se dëshmitë e parashtruara nga paditësi nuk kanë ndikim në vendosje ndryshe në këtë çështje administrative.

Neni 43, par 1. i LKA-së, *“Gjykata vendos për çështjen e konfliktit administrativ, në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurën administrative”*, andaj paditësi në këtë kontest tregtar administrative ka dështuar që të prezantojë provat me të cilat do të mbështet pretendimet e tij në padi, për arsye se është obligim i palës paditëse që të prezantojë para gjykatës faktet me të cilat e mbështet kërkesën e tij, si dhe një përmbledhje të arsyetimit ligjor dhe faktik të ankesës, ashtu siç parashihet me nenin Neni 81 F, paragrafi 1 dhe 81 E, paragrafi 4, pika 4 dh 5 të Ligjit nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222 .

Gjykata erdhi në përfundim se në këtë çështje administrative drejt është vërtetuar gjendja faktike, nga e cila del se nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit, andaj thëniet e padisë nuk i aprovoj sepse i vlerësoj të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuara nga e paditura.

Vendimi për shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 64, të LKA-së.

Nga të lartcekurat, Gjykata konform nenit 43 parag, 1, dhe nenit 46, parag. 2, të LKA-së ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**  
Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal  
KF.nr.898/22, datë 23.01.2025

Gjyqtarja  
Vera Gashi Bala

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.